



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Njoftim për mediat

Mbi abuzimin me pozitën dominuese të ndërmarrjes “ARMO” SHA në tregun e prodhimit të produktit lëndë djegëse diesel D2

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 20 Korrik 2010 ka shqyrtuar çështjen me objekt “Ekzistencën ose jo te abuzimit me pozitën dominuese të shoqërisë ARMO SHA në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të produktit lëndë djegëse diesel (D2)”.

Sjellja e ndërmarrjes ARMO SHA ka qënë objekt monitorimi nga Autoriteti i Konkurrencës kryesisht pas privatizimit. Në vijim të procedurave sipas Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, komisioni i Konkurrencës ka marrë vendim për hapjen e hetimit të thelluar me objekt ekzistencën ose jo te abuzimit me pozitën dominuese të shoqërisë ARMO SHA në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të produktit lëndë djegëse diesel (D2) për periudhën 01 janar deri në 31 tetor 2009. Në bazë të këtij vendimi Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me ligjin nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të këtij hetimi, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës “Raportin e hetimit të thelluar”.

Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në datën 10 qershor 2010, u organizua seanca dëgjimore ku pala nën hetim ka paraqitur pretendimet e saj mbi raportin e hetimit të thelluar.

Mbi bazën e vlerësimit të pozitës dominuese të ndërmarrjes ARMO SHA në lidhje me analizinë e pjesës së tregut që zë kjo ndërmarrje në tregun përkatës lëndë djegëse diesel (D2) për makina dhe makineri, pengesave të hyrjes në treg, konkurrencës potenciale, fuqisë ekonomike të ndërmarrjeve, fuqisë kundërvepruese të blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut përkatës, ka rezultuar se kjo ndërmarrje për periudhën në hetim ka patur pozitë dominuese në tregun përkatës objekt hetimi.

Sipas evidencave të administruara ka rezultuar se ndërmarrja “ARMO” SHA, gjatë periudhës nën hetim ka zbatuar çmime dhe kushte të ndryshme tregtimi për veprime të njëjta tregtare me palët, duke vendosur në kushte të pafavorshme konkurrence ndërmarrjet që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të produktit lëndë djegëse diesel D2.

Ndërmarrja “ARMO” SHA duke pasur një pozitë dominuese në tregun përkatës është e detyruar të zbatojë rregullat e sjelljes për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenin 8, nenin 9, pika 1, dhe pika 2 germa (c), nenin 74, pika 1, germa (a) dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi:

1. Ndërmarrja “ARMO” SHA ka abuzuar me pozitën dominuese për periudhën 1 janar 2009 - 22 gusht 2009, në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2, duke vendosur kushte të pabarabarta tregtimi ndaj ndërmarrjeve të ndryshme për të njëjtat veprime tregtare;
2. Për shkeljen e konstatuar në pikën 1, ndërmarrja “ARMO: SHA të gjobitet në shumën 271,880,720 Lekë që përbën 2,6% të xhiros totale vjetore të vitit 2009.
3. Mbyllet e hetimit të thelluar në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2 për ndërmarrjen “ARMO” SHA, të nisur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 129, datë 19.11.2009;

Për zbatimin e këtij vendimi, në bazë të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ngarkohet Drejtoria e Hetimit Tatimor (ish-Policia Tatimore), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.